

Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë,01.06.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 31.05.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Shkoza 007&Çlirimi 99", për aktivitetin: "Ndertimi i shtegut për ecje dhe vrapim Nr. të Prok: 616 20 7641 521 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Shkoza 007&Çlirimi 99" e datës 31.05.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i shtegut për ecje dhe vrapim" me Nr. të Prok: 616 20 107 512 kundër Njoftimit për Vendimin e Autoritetit Kontraktues, të datës 28.05.2021 të publikuara në web-faqe të KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë aktivitetin sipas publikimit të datës 28.05.2021
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Shkoza 007&Çlirimi 99" me datë 31.05.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i shtegut për ecje dhe vrapim" me Nr. të Prok: 616 20 7641 521.

Autoriteti Kontraktues, me datë 01.06.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet tuaja janë të pa bazuara pasi që tenderi juaj nuk është refuzuar për shkak të vlefshmërisë së tenderit, por për arsyen e mos plotësimit të kërkesave teknike dhe

profesionale.Pra ju nuk keni pretenduar te kontestoni arsyet e refuzimit,por keni paraqitur pretendime tjera qe nuk kane te bejne me Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe si te tilla jane te pa bazuara.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës , departamentit të prokurimit dhe njësis së kërkesës.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit